



OJQ “Kasneçët e Ardhmërisë” – KeA, është organizatë joqeveritare e cila zbaton projektin “Fuqizimi i Kontrollit të Tuberkulozit në Kosovë”, të financuar nga ana e GFATM nëpërmjet të CDF. Në lidhje me këtë projekt OJQ KeA hap thirrje për projekt propozime me titull:

Fuqizimi OJQ-ve nga radhët e komunitetit minoritar për zbatimin e aktiviteteve komunitare në kontrollin e Tuberkulozit

Qëllimi i aktivitetit:

Të fuqizohet komuniteti minoritar në komunat ku banojnë, me përfshirjen aktive në luftën kundër TB-së, përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese, edukative dhe mbështetëse për individët dhe familjet në rrezik.

Përshkrimi i përgjithshëm i projektit:

OJQ-ja/të përfituese do të zbatojnë një projekt/e me kohëzgjatje prej 1 deri në 3 muaj, me buxhet maksimal deri në 2,000 € (dymijë euro), që do të përfshijë aktivitete si:

- Senzibilizimi i komunitetit mbi sëmundjen e TB-së;
- Ndërtimi i kapaciteteve të pjesëtarëve të komunitetit në identifikimin, referimin dhe mbështetjen e trajtimit të TB.
- Krijimi i rrjetit të vullnetarëve lokalë.
- Rrjetëzimi me OJQ tjera.

Kriteret e përzgjedhjes:

OJQ-të aplikante duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të jenë të regjistruara në Kosovë dhe të jenë pjesë apo përfaqësojnë komunitetin minoritar;
2. Të kenë përvojë punës me komunitete të marginalizuara;
3. Të posedojnë kapacitete për zbatim të aktiviteteve në terren;
4. Të paraqesin një propozim të shkurtër projekti (deri në 3 faqe) që përfshin qëllimin, rezultatet, aktivitetet, planin kohor dhe buxhetin e detajuar.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formulari i aplikimit (në dispozicion në zyrën e OJQ KeA ose me email);
- Kopja e regjistrimit të OJQ-së;
- CV e shkurtër e organizatës;

- Lista e aktiviteteve relevante të mëparshme;
- Propozimi i projektit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Aplikimet duhet të dorëzohen deri më datë 28 Shkurt 2026, ora 16:00 në adresën elektronike: rinarexha28@gmail.com; xhevat.kurhasani@gmail.com me titull: “Ndërtimi i kapaciteteve të OJQ-ve në komunitet mbi kontrollin e TB”

Përzgjedhja dhe njoftimi:

Në këtë projekt mund të jenë fituese më shumë se një OJQ. OJQ-të do të vlerësohen në bazë të cilësisë së propozimit dhe rezultatet e pritshme. Vetëm OJQ-a/të e përzgjedhura do të kontaktohen për nënshkrimin e marrëveshjes.

Financimi:

Ky aktivitet financohet nga Global Fund (GFATM)./CDF përmes OJQ KeA, në kuadër të projektit kombëtar për kontrollin e Tuberkulozit në Kosovë.

Për më shumë informata:

OJQ KeA

Email: rinarexha28@gmail.com; xhevat.kurhasani@gmail.com

Tel: 044959636/044189640